

## **Njoftim mbi Privatësinë & Kushtet e Përdorimit**

### **JU LUTEMI LEXOJENI ME KUJDES DHE PRANOJENI PËRPARA SE TË SHKARKONI DHE TË PËRDORNI APLIKACIONIN d.CARE.**

#### **Njoftim mbi Privatësinë**

Data efektive: 21 prill 2020

Shoqëria Diaverum AB dhe degët e saj ("Diaverum") respektojnë privatësinë tuaj. Ky Njoftim mbi Privatësinë vlen për përdoruesit e regjistruar në aplikacionin Diaverum d.CARE në celular dhe në faqen e internetit (së bashku referuar si "Aplikacioni"). Ky dokument tregon llojet e të dhënave personale që ne mbledhim dhe përpunojmë në lidhje me Aplikacionin, qëllimet përse ne mbledhim këto të dhëna personale, palët e tjera me të cilat ne i ndajmë dhe masat e marra për mbrojtjen e sigurisë së të dhënave. Gjithashtu, ai shpjegon të drejtat dhe zgjedhjet tuaja në lidhje me të dhënat tuaja personale, dhe si mund të na kontaktoni për të marrë përgjigjet e pyetjeve që mund të keni rreth praktikave të privatësisë. Nëse ju nuk jeni dakord me Politikën e Privatësisë dhe Kushtet e Përdorimit të Aplikacionit d.CARE, atëherë nuk do të krijohet një llogari në d.CARE dhe ju nuk mund të përdorni Aplikacionin. Me përjashtim të sa parashikohet në Seksionin 7, subjekti përgjegjës, kontrolluesi i të dhënave, për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave tuaja personale në kuadrin e Aplikacionit është:

Diaverum AB

DIAVITA sh.p.k. (L52305009L)

Rr. Kajo Karafili, P. Bimbashi, Godina Bimbashi

Hyrja 1, Kati 2, Nr. 3

Diaverum ka caktuar një Përgjegjës për Mbrojtjen e të Dhënave (DPO) që mund të kontaktohet me shkrim, duke përdorur informacionin në adresën e mësipërme ose postën elektronike: [edona.krasniqi@diaverum.com](mailto:edona.krasniqi@diaverum.com)

#### **1. Të dhënat Personale që ne mbledhim**

##### *a. Të dhënat personale të siguruar nga ju*

Ju çdo ditë mund të vlerësoni se si ndiheni dhe të shkruani një tekst personal lidhur me përdorimin e Aplikacionit. Në varësi të modalitetit, ju mund të hidhni matjet dhe rezultatet e trajtimit tuaj të hemodializës ose DP-së, duke përfshirë fotografi të vendit të daljes së kateterit. Qëllimi është që t'ju mundësojë ju dhe stafin e autorizuar që të ndjekë perceptimin e mirëqenies suaj. Baza ligjore për këtë përpunim është pëlqimi juaj i informuar.

##### *b. Të dhëna personale të siguruar nga burime të tjera*

Shumica e informacionit në Aplikacion ju ofrohet ka si burim klinikën Diaverum dhe sistemin e menaxhimit të pacientëve. Këtu përfshihen:

- të dhënat e llogarisë suaj të regjistruar (identiteti i përdoruesit, numri i telefonit, zona kohore, lloji i modalitetit),

- pjesë të përzgjedhura të recetës suaj, duke përfshirë mjekimin,
- pjesë nga rezultatet e trajtimit tuaj me dializë,
- pjesë nga të dhënat e testeve tuaja laboratorike.

Qëllimi është që t'ju mundësojmë të ndiqni informacione të rëndësishme lidhur me trajtimin tuaj të dializës. Baza ligjore për këtë përpunim është pëlqimi juaj i informuar.

### *c. Informacioni që ne mbledhim në mënyrë automatike*

Ne mund të përdorim Google Analytics for Firebase për të mbledhur disa informacione specifike anonime nëpërmjet mënyrave automatike kur ju përdorni Aplikacionin ("Informacion Përdorimi"), i tillë si informacioni rreth aspekteve të Aplikacionit që ju përdorni ose vizitoni, data dhe koha kur aksesoni Aplikacionin, dhe sa kohë shpenzoni me Aplikacionin, shfletuesin e internetit në celular, modelin dhe sistemin e operimit të Pajisjes suaj, dhe informacione të tjera të përshkruara në këtë Njoftim mbi Privatësinë. Ju mund të hiqni opsionin e Google Analytics for Firebase duke ndryshuar cilësimet. Shihni edhe <https://policies.google.com/privacy>.

Të dhënat e mbledhura në mënyrë automatike përpunohen me qëllim përmirësimin e Aplikacionit dhe ofrimin e informacionit dhe shërbimeve më të mira. Ne mund të marrim dhe adresën IP të pajisjes celulare ose ndonjë identifikues tjetër unik ("Identifikuesi i Pajisjes") për çdo telefon celular, tabletë apo pajisje tjetër (çdo "Pajisje") që përdoret për të aksesuar Platformat. Pajisjes suaj i caktohet automatikisht një Identifikues Pajisjeje, dhe nëpërmjet tij serverat tanë identifikojnë Pajisjen tuaj. Baza ligjore për këtë përpunim është pëlqimi juaj i informuar.

## **2. Si i përdorim Të Dhënat Personale**

Ne mund të përdorim të dhënat personale të siguruar nga ju në lidhje me Aplikacionin për të:

- Ofruar informacion dhe statistika rreth trajtimeve tuaja të dializës me Diaverum.
- Gjeneruar dhe shpërndarë informacionin tuaj të hyrjes në llogari në mënyrë të sigurt.
- Krijuar dhe menaxhuar llogarinë tuaj, ofrimin e produkteve dhe shërbimeve tona, dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja;
- Mbrojtur dhe parandaluar mashtrimin; aktivitetin e paautorizuar; pretendime dhe përgjegjësi të tjera; dhe menaxhimin e ekspozimit ndaj rrezikut dhe cilësisë së franshizës;
- Operuar, vlerësuar dhe përmirësuar biznesin tonë (duke përfshirë zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja; menaxhimin e komunikimeve tona; lehtësimin e funksionalitetit të aplikacionit tonë celular);
- Monitoruar përdorimin dhe përmirësuar asetet tona interaktive;
- Zbatuar Kushtet tona të Përdorimit;
- Respektuar kërkesat e zbatueshme ligjore, standardet e industrisë dhe politikat tona;
- Përgjigjur dhe përpunuar kërkesat, ankesat, mosmarrëveshjet; dhe
- Kryer auditim, punë kërkimore dhe analiza me qëllim mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e shërbimeve tona.
- Ne mund të përdorim informacionin edhe në mënyra të tjera për të cilat do të paraqesim një njoftim të posaçëm gjatë mbledhjes së këtij informacioni.

Njoftimet brenda Aplikacionit: Nëse ju jeni një përdorues i regjistruar i Aplikacionit, ju mund të merrni kujtesa në seksionin e Njoftimeve brenda Aplikacionit, të tilla si kujtesa për të shënuar se si ndiheni. Ju mund të menaxhoni preferencat e njoftimeve ose të çaktivizoni këto njoftime në çdo kohë duke çaktivizuar opsionin e njoftimeve në Aplikacion ose në Cilësimet e Pajisjes suaj celulare.

Fotografitë dhe Kamera: Ne nuk do të aksesojmë fotografitë apo kamerën tuaj pa e filluar ju më parë. Nëse ju do të filloni aksesin në fotografi apo kameran tuaj, ne do të përdorim vetëm imazhet që ju zgjidhni të ngarkoni. Ju mund të menaxhoni në çdo kohë preferencat e Fotografive dhe Kamerës suaj duke fikur këtë veçori në Cilësimet e Pajisjes suaj celulare.

### **3. Të dhënat Personale që ne i ndajmë**

Ne nuk shesim apo bëjmë publike të dhënat personale që ne mbledhim ose ruajmë, me përjashtim të sa përshkruhet në këtë Njoftim mbi Privatësinë apo çka ju bëjmë juve publike në kohën e mbledhjes së këtyre të dhënave.

Ofruesit e Shërbimit: Ne mund të ndajmë të dhënat personale me ofruesit tanë të shërbimit, të cilët kryejnë shërbime në emër tonë, të tilla si shoqëritë që zhvillojnë dhe mbështesin operimin e Aplikacionit dhe dërgojnë emaile apo komunikime të tjera elektronike. Ne nuk autorizojmë këta përdorues shërbimesh që të përdorin apo të bëjnë publike të dhënat, vetëm kur është e nevojshme të kryejnë shërbime të caktuara në emrin tonë ose në përputhje me kërkesat ligjore. Ne u kërkojmë këtyre ofruesve të shërbimeve në mënyrë kontraktuale që të ruajnë siç duhet privatësinë dhe sigurinë e të dhënave personale që ata përpunojnë në emrin tonë.

Stafi i klinikave Diaverum: Te dhenat tuaja personale qe do te perdori ne aplikacion do t'i vihen në dispozicion personelit në klinikën tuaj nëpërmjet një sistemi të siguruar ku do të ketë akses vetëm personeli i autorizuar.

Me zgjedhjen tuaj, ju mund ta ndani informacionin personal në aplikacion me stafin e klinikës duke ia paraqitur fizikisht përmbajtjen e shfaqur në ekranin e pajisjes suaj.

Arsye Administrative dhe Ligjore: Ne mund të bëjmë publike të dhënat rreth jush: (i) nëse jemi të detyruar me ligj ose për shkak të një procesi ligjor, (ii) për autoritetet ligjzbatuese apo zyrtarë të tjerë qeveritarë, ose (iii) kur ne besojmë se bërja publike është e nevojshme ose e duhur për parandalimin e lëndimit fizik ose humbjeve financiare, ose në lidhje me një hetim të një aktiviteti të jashtëligjshëm apo mashtrues të dyshuar apo aktual.

### **4. Të Drejtat dhe Zgjedhjet tuaja**

Ju keni të drejtën që të kërkonte akses në çdo të dhënë tuajën personale që përpunon Grupi i Diaverum. Për më tepër, ju keni të drejtë të kërkonte korrigjimin e të dhënave personale të pasakta apo të paplota. Ju gjithashtu keni të drejtë që, në çdo kohë, të tërhiqni pëlqimin tuaj, nëse është e aplikueshme, për përpunimin e të dhënave tuaja personale nga Grupi i Diaverum, me efekt në të ardhmen.

Në masën e parashikuar në legjisllacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave, ju gjithashtu keni të drejtë të kundërshtoni një përpunim të caktuar të të dhënave personale, keni të drejtën për të kërkuar kufizim të përpunimit të të dhënave tuaja personale dhe të drejtën për transportueshmëri të të

dhënave. E drejta për transportueshmërinë e të dhënave mbulon ato të dhëna personale që ne përpunojmë në bazë të marrëveshjes së lidhur mes nesh ose në bazë të pëlqimit tuaj.

Nëse keni ndonjë pyetje apo shqetësim lidhur me përpunimin e të dhënave tuaja personale nga Grupi Diaverum, ju lutemi kontaktoni klinikën tuaj.

Gjithashtu, ju keni të drejtën që të paraqisni një ankim pranë autoritetit kombëtar të mbrojtjes së të dhënave.

## **5. Si i mbrojmë Të Dhënat tuaja Personale**

Ne kemi masat e duhura administrative, teknike dhe fizike për të mbrojtur të dhënat personale ndaj shkatërrimit aksidental apo të paligjshëm, humbjes aksidentale, modifikimit të paautorizuar, bërjes publike apo aksesit të paautorizuar, keqpërdorimit dhe çdo forme tjetër të paligjshme të përpunimit të të dhënave personale që ne disponojmë. Krahas kësaj, ne marrim masa për shkatërrimin e përhershëm të identifikimit të informacionit personal kur nuk ka më një qëllim të vlefshëm për mbajtjen e informacionit. Llojet e masave që ne marrim variojnë me llojin e informacionit, dhe se si mbliidhet e ruhet.

Ju lutemi vini re se asnjë mbledhje apo transmetim të dhënash nuk mund të jetë 100% i sigurt. Prandaj, ndërkohë që përpiqemi që të mbrojmë të dhënat tuaja personale, ne nuk mund të sigurojmë apo garantojmë sigurinë e transmetimit të të dhënave.

Ne asnjëherë nuk do t'ju kërkojmë fjalëkalimin në asnjë komunikim të padëshiruar (duke përfshirë korrespondencën e padëshiruar, si letra, telefonata, apo mesazhe email-i). Nëse mendoni se emri i përdorimit dhe fjalëkalimi juaj janë komprometuar, ju lutemi kontaktoni menjëherë klinikën tuaj.

Të gjitha të dhënat lidhur me dhe të aksesueshme përmes Aplikacionit d.Care ruhen në serverat e qendrës së të Dhënave të Diaverumit në Suedi. Për përdoruesit nga Rusia, Kazakistani apo Arabia Saudite, qendrat e të dhënave ndodhen në vendet përkatëse.

## **6. Transferimi i të Dhënave**

Të dhënat personale nuk transferohen në një vend të tretë. Informacioni i Përdorimit i Google Analytics for Firebase mund të transferohet jashtë Zonës Ekonomike Evropiane/ Rusisë/ Arabisë Saudite. Diaverum nuk kombinon informacione të mbledhura nëpërmjet Google Analytics me informacione të tjera personale. Google ka dërguar certifikatën e aderimit në Kuadrin e Mbrojtjes së Privatësisë së BE-SHBA.

## **7. Veçori dhe Linqe në faqe të tjera të internetit**

Aplikacioni ynë mund të përmbajë veçori të caktuara për të cilat ne lidhim partneritet me subjekte të tjera ose ofrojmë linqe të faqeve të tjera të internetit për informacionin dhe lehtësinë tuaj. Këto veçori mund të përfshijnë rrjete sociale, mjete të vendndodhjes gjeografike dhe linqe në aplikacione dhe faqe të tjera interneti, të cilat mundet, ose jo, të zotërohen apo operohen nga Diaverum. Këto veçori, faqe interneti apo aplikacione celulare të tjera mund të kenë njoftimet apo politikat e tyre të privatësisë, që ju sugjerojmë t'i shqyrtoni. Në masën që ndonjë veçori ose faqe e lidhur interneti që vizitoni nuk janë në pronësi ose nuk operohen nga Diaverum, ne nuk jemi përgjegjës për përmbajtjen e faqeve, çdo përdorim të faqeve apo praktikat e privatësisë së faqeve.

## **8. Përditësimi i Politikës sonë së Privatësisë**

Kjo Politikë Privatësie mund të përditësohet në mënyrë periodike dhe pa një njoftim paraprak për të pasqyruar ndryshimet në praktikën tonë të dhënave personale. Në Aplikacion, ne do t'ju kërkojmë që të rishikoni dhe të jepni pëlqimin tuaj për Politikën e ndryshuar të Privatësisë dhe në fillim të njoftimit do të tregohet se kur ka qenë përditësimi më i fundit.

## **9. Si të na kontaktoni**

Nëse keni ndonjë pyetje apo koment rreth kësaj Politike Privatësie ose nëse dëshironi të ushtroni të drejtat tuaja apo të përditësoni informacionin që kemi rreth jush ose preferencat tuaja, ju mund të kontaktoni klinikën tuaj ose të drejtoheni me shkrim në adresën e mësipërme.

Për t'iu asistuar me përgjigjen e kërkesës suaj, ju lutemi jepni detajet e plota të çështjes, duke përfshirë dhe faktin që kërkesa juaj lidhet me Aplikacionin Diaverum d.CARE.

\*\*\*\*\*

## **Kushtet e përdorimit**

### **Hyrje**

Diaverum ka zhvilluar Aplikacionin d.CARE për të përmirësuar përfitimet dhe përvojën e pacientëve të tij të dializës. Përdorimi i Aplikacionit i nënshtrohet pranimit tuaj të termave, kushteve dhe dhënies së pëlqimit.

Në bazë të këtyre kushteve, ne ju licensojmë përdorimin e Aplikacionit dhe Dokumenteve, të cilat i nënshtrohen rregullave apo politikave të çdo ofruesi apo operatori të dyqanit të aplikacioneve nga ku ju keni shkarkuar Aplikacionin (**Rregullat e Dyqanit të Aplikacioneve**). Ne nuk iu shesim ju Aplikacionin apo Dokumentet. Ne, kurdoherë, jemi zotëruarit e Aplikacionit dhe Dokumenteve.

### **KËRKESAT E OPERIMIT TË SISTEMIT**

KY APLIKACION KËRKON NJË PAJISJE iOS OSE ANDROID ME AKSES NË INTERNET. KY APLIKACION KËRKON NJË SISTEM OPERIMI TË PËRDITËSUAR NË PAJISJE.

### **NJOFTIM I RËNDËSISHËM: Pranimi i termave dhe kushteve**

Përdorimi i këtij Aplikacioni dhe lidhjet me çdo server, faqe interneti apo linqe të shoqëruar me Aplikacionin rregullohet nga termat dhe kushtet e përcaktuara më poshtë.

- Duke shkarkuar ose transmetuar vazhdimisht Aplikacionin, ju pranoni kushtet e licensës që ju lidhin në mënyrë kontraktuale. Kushtet e licensës përfshijnë, në veçanti, politikën e privatësisë të përcaktuar më sipër dhe kufizimet e përgjegjësisë në pikën 15.
- Nëse se ju nuk pranoni këto terma dhe kushte, ne nuk do t'ju licensojmë Aplikacionin dhe Dokumentet dhe ju duhet të ndaloni menjëherë procesin e shkarkimit apo transmetimit. Në këtë rast, ju nuk mund të aksesoni, përdorni apo të shkarkoni as Aplikacionin as materialet apo funksionet e lidhura me të.

**Ju duhet të printoni ose të ruani një kopje të këtyre kushteve për t'iu referuar në të ardhmen.**

### **KUSHTET E DAKORDËSUARA:**

## **1. Përdorimi i Aplikacionit**

Këto kushte vlejné për Aplikacionin apo cilindo shërbim të aksesueshëm përmes Aplikacionit (**Shërbime**), duke përfshirë çdo përditësim apo shtesa të Aplikacionit ose Shërbimeve, vetëm nëse ato shoqërohen me kushte të veçanta, të cilat do të jenë të zbatueshme.

Funksionaliteti i Aplikacionit dhe informacioni dhe të dhënat e ofruara apo të aksesuara nëpërmjet Aplikacionit janë subjekt ndryshimi. Diaverum rezervon të drejtën për modifikimin ose përditësimin e këtyre kushteve në çdo kohë, pa njoftim paraprak, por do të njoftoheni për ndryshimin momentin që ju hapni Aplikacionin. Kushtet e reja mund të shfaqen në ekran dhe mund t'ju kërkohet që të lexoni dhe të pranoni ato në mënyrë që të vazhdoni përdorimin e Shërbimeve. Përdorimi juaj i vazhdueshëm i Aplikacionit pas këtij ndryshimi përbën marrëveshjen tuaj për t'u pajtuar me të gjitha këto ndryshime. Ju pranoni përgjegjësinë në përputhje me këto kushte për përdorimin e Aplikacionit apo cilindo Shërbim në lidhje me një kompjuter, laptop, telefon celular, pajisje dore apo pajisje tjetër që akseson internetin (**Pajisjet**) në të cilin shkarkohet apo transmetohet Aplikacioni, qoftë në pronësinë tuaj ose jo. Supozohet që ju keni marrë lejen e pronarit të Pajisjeve që kontrollohen nga ju, por që nuk janë në pronësinë tuaj. Ju dhe ata mund të tarifoheni nga ofruesi juaj apo i tyre i shërbimeve për aksesin në internet.

## **2. Nuk është një zëvendësim i këshillave mjekësore**

Ju nuk duhet të mbështeteni te informacioni i përftuar nga ky Aplikacion si një alternativë ndaj këshillave mjekësore apo trajtimit të mjekut tuaj apo ndonjë ofruesi tjetër profesional të kujdesit shëndetësor. Informacioni i ofruar në këtë Aplikacion do t'ju ndihmojë që të monitoroni kujdesin tuaj shëndetësor. Ai nuk përbën këshillë mjekësore dhe nuk ka për qëllim që të zëvendësojë kujdesin ose këshillën mjekësore të ofruar nga mjeku apo profesionisti shëndetësor.

Diaverum nuk mban përgjegjësi për asnjë rrethanë që lind nga përdorimi, keqpërdorimi, interpretimi apo aplikimi i ndonjë informacioni të përftuar nga përdorimi i Aplikacionit.

Ju garantoni dhe pranoni që gjithmonë të konsultoheni me mjekun ose ofruesin e kujdesit shëndetësor për ekzaminimet e duhura, trajtimet, rekomandime për testime dhe të kujdesit shëndetësor, dhe që asnjëherë nuk do të vononi të kërkoni këshilla mjekësore, të mos respektoni këshillat mjekësore ose të ndërpritni trajtimin mjekësor për shkak të informacionit të përftuar nga përdorimi i Aplikacionit.

## **3. Dhënia dhe qëllimi i licensës**

Duke marrë parasysh që ju pranoni të respektoni këto kushte, ne ju japim një licensë jo të transferueshme dhe jo-ekskluzive për të përdorur Aplikacionin në çdo pajisje, duke iu nënshtruar këtyre kushteve, politikës sonë të privatësisë (siç përcaktohet më sipër) dhe Rregullat e Dyqanit të Aplikacioneve, të përfshira në këto kushte të referuara. Ne rezervojmë të gjitha të drejtat e tjera.

Ju mund të:

- a. shkarkoni ose transmetoni një kopje të Aplikacionit në çdo numër pajisjesh për të parë, përdorur dhe shfaqur Aplikacionin në këto Pajisje vetëm për qëllimet tuaja personale; dhe
- b. përdorni Dokumentet vetëm për qëllimet tuaja personale.

## **4. Kufizimet e licensës**

Me përjashtim të sa përcaktohet shprehimisht në këto kushte apo sa lejohet nga legjislacioni vendor, ju pranoni:

- a. të mos kopjoni Aplikacionin ose Dokumentet, përveç kur kopjimi i tillë është i rastësishëm për përdorimin normal të Aplikacionit, ose kur është e nevojshme për qëllime të sigurimit operacional apo të një kopjeje rezervë;
- b. të mos jepni me qira, merrni me qira, të nën-licensoni, të jepni hua, të përktheni, bashkoni, përshtatni, ndryshoni apo modifikoni Aplikacionin ose Dokumentet;
- c. të mos kryeni ndryshime apo modifikime, të të gjithë apo një pjesë të Aplikacionit, ose të lejoni që Aplikacioni apo një pjesë e tij të kombinohet ose të përfshihet në programe të tjera;
- d. të mos çmontoni, dekompiloni, dekonstruktioni ose të krijoni vepra derivative bazuar në të gjithë ose ndonjë pjesë të Aplikacionit ose të përipiqeni të bëni ndonjë gjë të tillë, përveç në masën që veprime të tilla nuk mund të ndalohen, sepse ato janë thelbësore për qëllimin e arritjes së ndërveprimit të Aplikacionit me një program tjetër softuer, dhe me kusht që informacionet e marra nga ju gjatë këtyre aktiviteteve:
  - i. përdoren vetëm me qëllimin e arritjes së ndërveprimit të Aplikacionit me një program tjetër softuer;
  - ii. nuk bëhen publike ose i komunikohen një pale të tretë në mënyrë të panevojshme pa pëlqimin tonë paraprak; dhe
  - iii. nuk përdoren për krijimin e një softueri që është shumë i ngjashëm me Aplikacionin;
- e. të mbani të sigurt të gjitha kopjet e Aplikacionit;
- f. të përfshini të gjitha njoftimet e të drejtës së autorit për të gjitha kopjet e plota dhe të pjesshme që ju i bëni Aplikacionit në çdo mjet;
- g. të mos siguronit ose të vini në dispozicion Aplikacionin e plotë ose të pjesshëm (duke përfshirë kodin e objektit apo burimor), në cilëndo formë ndaj çdo personi pa pëlqimin tonë paraprak me shkrim; dhe
- h. të respektoni të gjitha kontrollet e teknologjisë apo ligjet dhe rregullimet e eksportit që zbatohen për përdorimin apo mbështetjen e teknologjisë nga Aplikacioni apo Shërbimi (**Teknologji**), së bashku **Kufizimet e Licensës**.

## 5. Kufizimet e pranuar të përdorimit

Ju nuk duhet të:

- a. përdorni Aplikacionin ose ndonjë Shërbim në mënyrë të paligjshme, për ndonjë qëllim të paligjshëm, ose në ndonjë mënyrë që nuk është në përputhje me këto kushte, ose të veproni duke mashtruar ose me qëllim të keq (për shembull, duke hakëruar ose futur kode të dëmshme, duke përfshirë viruset, ose të dhënat e dëmshme, në Aplikacion, Shërbim ose ndonjë sistem operativ);
- b. shkelni të drejtat tona të pronës intelektuale apo të një pale të tretë në lidhje me përdorimin tuaj të Aplikacionit apo Shërbimeve (në masën që ky përdorim nuk është i licensuar nga këto kushte);
- c. transmetoni asnjë material që është diskreditues, ofendues apo kundërshtues në lidhje me përdorimin tuaj të Aplikacionit apo Shërbimeve;
- d. përdorni Aplikacionin apo Shërbimet në mënyrë që mund të dëmtojnë, çaktivizojnë, mbingarkojnë, pengojnë ose komprometojnë sistemet apo sigurinë tonë ose të ndërhyjnë te përdoruesit e tjerë; dhe

- e. mblidhni informacion ose të dhëna nga Shërbimet apo sistemet tona ose të përpiqeni të deshifroni ndonjë transmetim të këtyre Shërbimeve nga serverat, së bashku **Kufizimet e Pranuara të Përdorimit**.

## **6. Mundësia për gabim**

Informacioni i mbajtur nga baza e të dhënave të grupit apo nga baza e të dhënave të Diaverumit është hedhur në mënyrë manuale, dhe në disa raste përmes një procesi të automatizuar. Informacioni është subjekt i gabimit të të dhënave, gabimit të pacientit, gabimit në programim dhe ju pranoni dhe bini dakord të përdorni Aplikacionin pavarësisht faktit se gabime të tilla ose informacione të pasakta mund të aksesohen ose të hidhen në bazën e të dhënave të Aplikacionit. Në këtë rast, ju nuk mund të ngrini asnjë pretendim ose të bëni përgjegjës Diaverum në asnjë mënyrë për ndonjë përgjegjësi, dëmtim ose humbje që vjen nga përdorimi i Aplikacionit.

Ju pranoni që Aplikacioni nuk është zhvilluar për të përmbushur kërkesat tuaja individuale, dhe për këtë arsye është përgjegjësi juaj të siguroni që lehtësirat dhe funksionet e Aplikacionit siç përshkruhen te Dokumentet plotësojnë kërkesat tuaja.

## **7. Përdorimi i Informacionit**

Diaverum bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme, por nuk mund të sigurojë ose garantojë që dosjet e disponueshme për shkarkimin e Aplikacionit nuk kanë viruse, apo kode të tjera kontaminuese ose shkatërruese. Diaverum nuk bën asnjë përfaqësim garancie ose miratimi të shprehur ose të nënkuptuar për çfarëdo lidhje me dosjet që janë shkarkuar për Aplikacionin ose dosjet e informacionit ose të dhënat që hidhen ose aksesohen duke përdorur Aplikacionin.

Diaverum nuk është përgjegjës ndaj jush apo dikujt tjetër për ndonjë vendim të marrë ose veprime të ndërmarra nga ju ose dikush tjetër në varësi të rezultateve të përfutuara nga përdorimi i dosjeve të shkarkuara nga Aplikacioni.

Ju pranoni të mos ribotoni ose riprodhoni në mënyrë elektronike asnjë dokument, kod, të dhëna ose send tjetër, pa pëlqimin e shprehur me shkrim nga Diaverum.

## **8. Garancitë**

Informacioni mjekësor dhe të dhënat e tjera të siguruara nga Aplikacioni ofrohen pa asnjë përfaqësim ose garanci, të shprehur apo nënkuptuar.

Diaverum nuk pretendon që informacioni mjekësor ose të dhënat e përfutuara nëpërmjet përdorimit të Aplikacionit:

- a. do të jenë vazhdimisht të disponueshme ose nëse do të jenë të disponueshme,
- b. janë të plota, të vërteta, të sakta dhe të përditësuara apo jo mashtruese.

## **9. Pajisjet e dorës ose që mundësojnë internetin**

Aplikacioni është projektuar që të punojë në Pajisje të caktuara. Nëse ju shikoni ose përdorni Aplikacionin në pajisje dore ose celulare ju mund të hasni në disa vonesa dhe kufizime të funksioneve. Ju mund të përjetoni mbulime dhe shpejtësi të ndryshme të rrjetit, në varësi të vendndodhjes suaj gjeografike dhe ofruesit të telekomunikacionit. Aplikacioni nuk duhet të përdoret ndërkohë që ju drejtoni një automjet, ose në cilëndo mënyrë që mund të rrezikojë veten tuaj dhe të tjerët. Duke përdorur Aplikacionin, ju pranoni shprehimisht që Diaverum nuk do të jetë përgjegjës për:

- a. kufizimet e performancës ose dështimet e përjetuara në lidhje;



- b. të dhëna të transmetuara përmes aksesit me valë që mund të përgjohen nga persona të paautorizuar; ose
- c. nga dështimi juaj për të siguruar fizikisht dhe monitoruar pajisjen tuaj ose mbrojtur fjalëkalimet tuaja duke çuar në akses të paautorizuar në informacionin e marrë nga Aplikacioni.

#### **10. Linqe në faqen zyrtare të Diaverumit apo faqe të tjera**

Duke përdorur Aplikacionin ju mund të aksesoni faqet e internetit të lidhura me Diaverum ose përmbajtje tjetër. Diaverum nuk rishikon, kontrollon ose miraton përmbajtjen dhe saktësinë e faqeve të internetit të ndonjë pale të tretë apo materiali tjetër dhe nuk është përgjegjës për përmbajtjen ose saktësinë e tyre.

Ju duhet të gjykoni në mënyrë të pavarur në lidhje me bashkëveprimin tuaj me ndonjë faqe në internet të palëve të treta, duke përfshirë blerjen dhe përdorimin e çdo produkti apo shërbimesh të aksesueshme përmes tyre.

#### **11. Informacioni i dërguar në serverin e Diaverumit**

Çdo informacion ose të dhëna që ju i dërgoni Diaverumit do të trajtohet si jo-pronësore por konfidenciale. Diaverum kryen të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar informacionin në përputhje me standardet e arsyeshme të industrisë, por ju pranoni që Diaverum nuk është përgjegjës për ndonjë bërje publike, humbje ose dëmtim që lind prej ose lidhet me ndonjë informacion të dërguar.

#### **12. Njoftimi për të drejtën e autorit**

Përmbajtja e Aplikacionit i nënshtrohet ligjeve të të drejtës së autorit. Ju mund të shkarkoni, ruani, dhe përdorni softuerin në lidhje me Aplikacionin për përdorimin tuaj personal, jokomercial dhe privat në përputhje me këto kushte. Është kusht që ju të mos postoni, publikoni apo transmetoni asnjë pjesë të Aplikacionit në ndonjë faqe apo media tjetër pa marrë pëlqimin paraprak me shkrim të Diaverumit. Ju pranoni që nuk do të modifikoni ose ndryshoni kodin apo softuerin në lidhje me Aplikacionin ose të përpiqeni të dekonstruktioni, modifikoni, dekompiloni, përshtatni, përktheni ose të çmontoni kodin burimor të aplikacionit.

#### **13. Shkelja e të drejtës së autorit nga Diaverum**

Diaverum ka zbatuar procedurat për marrjen e njoftimit të pretendimeve në lidhje me shkeljen nga Diaverum të ndonjë të drejte të palëve të treta. Në rast se ju keni, ose merrni një pretendim, ju duhet t'i dërgoni Diaverumit një njoftim që identifikon veprën e të drejtës së autorit që pretendohet të jetë shkelur, emrin dhe nënshkrimin e një personi të autorizuar për të përfaqësuar paditësin dhe çdo informacion tjetër që është i nevojshëm që Diaverum të gjejë materialin dhe të komunikojë me paditësin.

#### **14. Të drejtat e pronës intelektuale**

Ju pranoni që të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale në Aplikacion, Dokumente dhe Teknologji kudo në botë na përkasin neve ose licensuesve tanë, që të drejtat në Aplikacion janë të licensuara (nuk shiten) për ju, dhe se nuk keni asnjë të drejtë në Aplikacion, Dokumente ose Teknologji, përveç të drejtës së përdorimit të secilës prej tyre në përputhje me këto kushte.

Çdo referencë në materialin e dhënë për markat tregtare ose emrat tregtarë konsiderohet se është pronë e pronarëve të atyre markave tregtare dhe emrave të markave tregtare. Vetëm nëse specifikohet nga Diaverum, ky i fundit nuk pretendon të jetë një agjent që vepron për ndonjë nga palët e treta të përmendura në materialin e transmetuar.

Ju pranoni që nuk keni asnjë licensë ose të drejtë të përdorni ndonjë prej markave tregtare të përmendura në faqen e internetit.

Ju pranoni që nuk keni të drejtë të keni akses në Aplikacion në formën e kodit burimor.

#### **15. Ngjarje jashtë kontrollit tonë**

Në rast se ndonjë veprim ose ngjarje që është jashtë kontrollit tonë të arsyeshëm prek realizimin e detyrimeve tona sipas këtyre kushteve:

- a. detyrimet tona sipas këtyre kushteve pezullohen dhe koha për kryerjen e detyrimeve tona shtyhet për kohëzgjatjen e një ngjarje të tillë; dhe
- b. ne do të përpiqemi në mënyrë të arsyeshme për të gjetur një zgjidhje përmes së cilës detyrimet tona sipas këtyre kushteve mund të kryhen pavarësisht një ngjarjeje të tillë.

#### **16. Deklaratë për mohimin e garancive dhe kufizimi i përgjegjësisë**

Kjo është një përmbledhje e të drejtave tuaja ligjore kyçe. Ato janë subjekt i përjashtimeve të caktuara. Përmbajtja digjitale (siç është një aplikacion) duhet të jetë siç përshkruhet, e përshtatshme për qëllimin dhe me cilësi të kënaqshme:

- a. nëse Aplikacioni është i gabuar, ju keni të drejtë për një riparim ose një zëvendësim; dhe
- b. nëse mund të tregoni se gabimi ka dëmtuar Pajisjen tuaj dhe ne nuk kemi përdorur aftësi dhe kujdes të arsyeshëm, ju mund të keni të drejtën për një riparim ose kompensim.

Ne ofrojmë Aplikacionin dhe Dokumentet vetëm për përdorim shtëpiak dhe privat. Me përjashtim të sa përcaktohet diku tjetër në këto kushte, ju pranoni:

- a. të mos përdorni Aplikacionin dhe Dokumentet për ndonjë qëllim komercial, biznesi ose rishitje, dhe ne nuk kemi përgjegjësi ndaj jush për ndonjë humbje fitimi, humbje biznesi, ndërprerje biznesi ose humbje të mundësisë së biznesit;
- b. të përdorni Aplikacionin dhe Shërbimet në rrezikun tuaj;
- c. që në asnjë rast Diaverum nuk do të jetë përgjegjës për dëmet, duke përfshirë pa kufizime dëme të drejtpërdrejta ose të tërthorta, dëme aksidentale ose me pasoja, humbje ose shpenzime në lidhje me ndonjë dështim të performancës, gabim, mosveprim, ndërprerje, defekt ose vonesë në funksionim ose transmetim të sistemit shëndetësor të mbështetur nga Aplikacioni; dhe
- d. në masën e lejuar me ligj, të lironi Diaverum nga çdo pretendim, veprim, përgjegjësi ose shpenzim të çfarëdo natyre që lind nga ose lidhet me përdorimin e Aplikacionit, Shërbimeve ose Dokumenteve.

Për shmangien e çdo dyshimi, ne nuk do të jemi të detyruar ose përgjegjës për ndonjë mospërmbushje, ose vonesë në kryerjen e ndonjë prej detyrimeve tona sipas këtyre kushteve, të shkaktuar nga ndonjë veprim ose ngjarje përtej kontrollit tonë të arsyeshëm.

Asgjë në këto kushte nuk do të kufizojë ose përjashtojë përgjegjësinë tonë për:

- a. vdekjen ose lëndimin personal që vjen nga pakujdesia jonë;
- b. mashtrimin ose keqpërfaqësimin; dhe
- c. çdo përgjegjësi tjetër që nuk mund të përjashtohet ose kufizohet me ligj.

### **17. Përgjegjësia juaj ndaj nesh**

Ju pranoni që do të jeni përgjegjës ndaj Diaverum, dhe premtoni të rimbursoni Diaverum, në lidhje me çdo pretendim, veprim, kërkesë, kosto, dëm, shpenzim dhe humbje (duke përfshirë, por pa u kufizuar në ndonjë humbje të drejtpërdrejtë, të tërthortë ose me pasojë, humbje të fitimit, humbje të reputacionit dhe të gjithë interesit, penaliteteve dhe kostove ligjore dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet e tjera të arsyeshme profesionale) të pësuar nga Diaverum që rrjedhin nga, ose lidhen me, ndonjë shkelje të këtyre kushteve nga ana juaj.

Detyrimet sipas pikës 18 mbeten në fuqi edhe nëse kontrata zgjidhet sipas pikës 18.

### **18. Përfundimi i shërbimit**

Diaverum rezervon të drejtën të ndërpresë menjëherë aksesin tuaj në Aplikacion dhe Shërbime nëse përcakton në diskrecionin e vet dhe absolut që ju:

- a. keni kryer një shkelje materiale ose të vazhdueshme të këtyre kushteve, të cilat nuk arrini t'i korrigjoni (nëse mund të korrigjohen) brenda 14 ditëve pasi ju njoftoheni me shkrim, duke kërkuar që ju të bëni atë; ose
- b. nëse shkelni ndonjë nga Kufizimet e Licensës ose Kufizimet e Pranuarat të Përdorimit.

Ju nuk keni të drejtë të ndryshoni mendim në lidhje me hyrjen tuaj në këtë marrëveshje të kushteve të përdorimit me ne, pasi të keni filluar të shkarkoni ose transmetoni Aplikacionin. Sidoqoftë, ju mund të zgjidhni kontratën tuaj menjëherë duke na njoftuar me shkrim. Ju lutemi vini re se nëse e zgjidhni kontratën kur ne nuk jemi në faj, atëherë neve mund të na lind e drejta për kompensim të arsyeshëm për kostot neto që do të pësojmë si rrjedhojë e zgjidhjes së kontratës.

Në rast zgjidhjeje për cilëndo arsye:

- a. ndërpriten të gjitha të drejtat që gëzoni sipas këtyre kushteve;
- b. ju duhet të ndërpriteni menjëherë të gjitha aktivitetet e autorizuar nga këto kushte, duke përfshirë përdorimin tuaj të çdo Shërbimi; dhe
- c. duhet të fshini ose hiqni menjëherë Aplikacionin nga të gjitha Pajisjet, dhe të shkatërroni të gjitha kopjet e Aplikacionit dhe Dokumenteve, në zotërimin, kujdestarinë apo kontrollin tuaj dhe të na vërtetoni se ju keni vepruar kështu.

### **19. Komunikimet mes nesh**

Nëse dëshironi të na kontaktoni me shkrim, ose nëse ndonjë nga këto kushte kërkon që të na njoftoni me shkrim, ju mund të na kontaktoni me postë elektronike ose me postë të parapaguar duke përdorur të dhënat e kontaktit më sipër. Ne do ta konfirmojmë marrjen e njoftimit duke ju kontaktuar me shkrim, normalisht me email.

Nëse keni ndonjë pyetje ose ankesë lidhur me Aplikacionin ose Shërbimin, ju lutemi na kontaktoni me shkrim ose me email. Si përdorues i regjistruar, ju mund të kontaktoni gjithnjë me klinikën tuaj për çdo temë.

Nëse ne duhet të kontaktojmë me ju ose t'ju njoftojmë me shkrim, ne do ta bëjmë këtë me email ose me postë të parapaguar për të gjitha detajet përkatëse të kontaktit që ju na jepni.

### **20. Kushte të tjera të rëndësishme**

Ne mund t'i transferojmë të drejtat dhe detyrimet tona sipas këtyre kushteve një organizate tjetër, por kjo nuk do të ndikojë në të drejtat tuaja ose detyrimet tona sipas këtyre kushteve.

Ju mund të transferoni të drejtat ose detyrimet tuaja sipas këtyre kushteve një personi tjetër nëse biem dakord me shkrim.

Nëse nuk arrijmë të insistojmë që ju të përmbushni ndonjë nga detyrimet tuaja sipas këtyre kushteve, ose nëse ne nuk i zbatojmë të drejtat tona ndaj jush, ose nëse vonojmë të kryejmë këtë, kjo nuk nënkupton që ne kemi hequr dorë nga të drejtat tona ndaj jush dhe nuk nënkupton që ju nuk duhet të përmbushni këto detyrime. Nëse heqim dorë nga një mospërmbushje nga ana juaj, ne do ta bëjmë këtë vetëm me shkrim, dhe kjo nuk nënkupton që do të heqim dorë automatikisht nga çdo mospërmbushje e mëvonshme nga ju.

Secila prej këtyre kushteve operon veçmas. Nëse ndonjë gjykatë ose autoritet kompetent vendos që ndonjë prej këtyre kushteve është i paligjshëm ose i pazbatueshëm, kushtet e tjera do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Ju lutemi vini re se këto kushte, lënda dhe formulimi i tyre, rregullohen nga legjislacioni vendas. Ju dhe ne biem dakord që gjykatat vendore kanë juridiksion ekskluziv.

Kjo marrëveshje lidhet në datën që ju shkarkoni ose transmetoni Aplikacionin.

---

Unë pranoj termat dhe kushtet e mësipërme dhe jap pëlqimin për përdorimin e informacionit tim personal dhe mjekësor. Unë pranoj që ju të më vini menjëherë në dispozicion Aplikacionin dhe pranoj se do të humbas të drejtën për anulimin e marrëveshjes pasi të ketë filluar shkarkimi apo transmetimi i vazhdueshëm i Aplikacionit.